

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Mbi 500 mijë vizitorë deri në gusht, rritet interesi i turistëve të huaj në Pogradec - Euronews Albania
ADRESA	https://euronews.al/mbi-500-mije-vizitore-deri-ne-gusht-rritet-interesi-i-turisteve-te-huaj-ne-pogradec/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 16:25:56 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 16:23:53 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a4a7eaff06ae1a2a97cff4c9db7682066ab39746c0cdd302b1ca75558cfe5e0c
TEKSTI	473c6181464cc40d03f39868ecff5db4f2c1c693f0063098864200dfdc963748
PAMJA	97f100d2b6d26e3ba0480528fa6504b1cb5ff9af319275d76c05fa5be754e54a

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	72028e3ce0190fd8cb1aa3bb4aa0434c70b00dff3bd16a849896a409a230e1fb
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	54ed48543a6253cb20faf0026ba4de200ea88d62566e99edbe4b1e5f6894ea0c
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/72028e3ce0190fd8cb1aa3bb4aa0434c70b00dff3bd16a849896a409a230e1fb>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.


Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

SHBA Gjyqi i UÇK Krim në familje Fier Edi Rama

AKTUALITET | VENDI

Mbi 500 mijë vizitorë deri në gusht, rritet interesi i turistëve të huaj në Pogradec



19 Shtator 2026 | 18:23

Pogradeci, Lini dhe Tushemishti janë kthyer në destinacione të preferuara për turistët e huaj, të cilët vijnë nga Amerika, Australia, Japonia dhe vende të ndryshme evropiane.

Vetëm nga janari deri në gusht, rreth 500 mijë vizitorë kanë frekuentuar destinacionet dhe atraksionet turistike të Pogradecit. Ndër atraksionet më të vizituara është Bazilika Paleokristiane e Linit, me rreth 6 mijë vizitorë, kryesisht të huaj.

Interes të lartë kanë edhe Burimet e Drilonit, Parku Ujor Drilon-Tushemisht dhe Varret Monumentale të Selcës. Për turistët e huaj, juglindja dhe Shqipëria ofrojnë mundësinë për të vizituar disa destinacione në një kohë të shkurtër. Kjo ka bërë që qëndrimet e tyre të zgjasin nga një javë deri në dy muaj, si në rastin e një turisti gjerman.

"Kam ardhur nga Gjermania, përmes Malit të Zi, në Shqipëri dhe kam dy muaj që ndodhem këtu. Kam qenë edhe në Korçë, një qytet shumë i bukur, dhe tani kam dy javë që jam këtu. Njerëzit janë shumë të qetë dhe të relaksuar dhe kjo më pëlqen shumë. Shqipëria është vërtet një vend i bukur. Kam provuar gjithçka, ushqimi shqiptar është shumë i mirë dhe kam parë shumë vende të bukura", është shprehur një turist nga Gjermania.

Interes për zonën shprehin edhe turistët britanikë, të cilët veçojnë Liqenin e Ohrit, klimën dhe mundësitë për të eksploruar destinacionet përreth tij.

"Tani kemi ditën e tetë që jemi këtu. Liqeni i Ohrit është i mrekullueshëm, temperatura është shumë e këndshme dhe është fantastike për të notuar. Kemi qenë në Manastirin e Shën Naumit dhe kemi bërë një udhëtim me varkë nëpër liqen. Kjo është hera e parë që vij në Lin. Duket vërtet shumë bukur. Është vapë, shumë vapë, sidomos për një anglez", ka thënë një turist nga Anglia.

Fluksi i turistëve është reflektuar edhe në strukturat akomoduese. Sipas të dhënave, prenotimet kanë vijuar përgjatë gjithë sezonit, ndërsa një pjesë e konsiderueshme e njësive akomoduese vijnë të jenë të prenotuara edhe gjatë muajit shtator.

Vitin e kaluar Pogradeci e mbylli 12-mujorin me rreth 450 mijë turistë, ndërsa këtë vit pritet që deri në fund të vitit numri të kalojë mbi 550 mijë.

LAJMI I FUNDIT

18:03 Takimi i 42-të i FBI-së dhe elitës së sigurisë në Tiranë, nga krimi i organizuar te dronët dhe paratë e krimit

17:42 Zbardhet skema e tjetërsimit të pronave në Fier, ekzekutohen 3 masa sigurie

17:20 Nga robotët në shtëpi te AI në çdo biznes, 10 parashikimet teknologjike për vitin 2035

SHPËRNDAJE
ARTIKULLIN

17:10 Zhvillimi i Qëndrueshëm 2026, Rama: Përmbyllja e negociatave dhe integrimi në BE, objektiva e Shqipërisë

17:05 "The Independent" përfshin Shqipërinë mes 10 destinacioneve

16:53 Hamza viziton familjet Thaçi, Veseli dhe Krasniqi: Nuk janë vetëm dhe nuk do të jenë kurrë

TESTIM

Shiko në:

LAJME TË SUGJERUARA

AKTUALITET | LAJM KRYESOR | VENDI

Takimi i 42-të i FBI-së dhe elitës së sigurisë në Tiranë, nga krimi i organizuar te dronët dhe paratë e krimit

Tirana është bërë këto ditë qendra e një takimi të rëndësishëm të drejtuesve dhe ekspertëve të sigurisë nga SHBA-ja dhe Europa. Nga 19 deri më...

18:03 | 19/09/2026

AKTUALITET | VENDI

Zbardhet skema e tjetërsimit të pronave në Fier, ekzekutohen 3 masa sigurie

Prokuroria e Fierit ka thelluar këtë të shtunë hetimet lidhur me një rrjet tjetërsimi dhe përvetësimi të paligjshëm të pronave në njësinë administrative Levan. Sipas...

17:42 | 19/09/2026

AKTUALITET | LAJM KRYESOR | POLITIKË | VENDI

Zhvillimi i Qëndrueshëm 2026, Rama: Përmbyllja e negociatave dhe integrimi në BE, objektiva e Shqipërisë

Kryeministri Edi Rama, përmes një videomesazhi në kuadër të Momentit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm 2026, rikonfirmoi angazhimin e Shqipërisë për Agjendën 2030 dhe...

17:10 | 19/09/2026

TEMA

Vendi
Rajoni
Bota
Video

SHËRBIME

Live
Lajmi fundit
Na ndiqni
Euronews Radio
Për persona me aftësi të kufizuara

KOMPANIA

Rreth Euronews
Kushtet e përdorimit
Politika e cookie
Kontakttoni
Punësimi

Follow Euronews on all platforms:

Copyright © Euronews 2026

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.